



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KËSHILLI

Nr. 5316/ Prot.
2

Pogradec, më 24. 12 . 2021

Raport

Në zbatim të Ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” Neni 54, Komisioni i Ekonomisë realizoi procesin e konsultim publik me komunitetin në përputhje me Regulloren për Konsultimin Publik.

U organizuan takime publike, takime online, pyetësorë

U dhanë gjithsej 6 rekomandime

Përmbledhja e rekomandimeve ju dërgua për opinion Kryetarit të Bashkisë i cili në përgjigjen e tij dha përlqimin për 5 rekomandime dhe me shume keqardhje shtyu per vitin tjetër vetëm nje rekomandim .

Komisioni i ekonomisë në mbledhjen e tij të datës 09.12.2021 pasi shqyrtoi cdo rekomandim dhe opinionin e Kryetarit të Bashkisë, vendosi të marrë në konsideratë 5 rekomandime dhe të mos marrë në konsideratë vetem 1 rekomandime duke qënë se Bashkia e kishte të pamundur për ta realizuar këtë vit.

Raporti përkatës së bashku me argumentat e mosaprovimit ju paraqit Këshillit të Bashkisë.

Në bazë të kalendarit për konsultim publik u realizuan një sërë aktivitete:

1. Si fillim realizuam një anketim online . Për shkak të pandemisë anketimi online ishte aktiviteti kryesor i vjeljes së mendimit të qytetarëve për konsultimin publik. Anketimi online u la në sistem për një periudhë nga 1 Maj në dt 30 gusht 2021 .

Pyetësi u plotësua nga 267 persona në një raport 49,8% meshkuj me 50,2% femra. Prioritetet e qytetarëve për vitin 2022 ishin: Kujdesi Social për fëmijët dhe familjet si dhe Ndriçimi Publik. Sygjerimet kryesore nga qytetarët përgjithësisht ishin Rritja e fondit për rrugët rurale, cka u dakortësua nga Bashkia dhe u pasqyrua në buxhetin e vitit 2022.

2. U realizua një townhall , ku morën pjesë 70 persona, nga të cilët 50 meshkuj, 20 femra. Përpara townhall u realizuan takime në lagje dhe takime në Njësitë Administrative.

Nga townhall dhe takimet e tjera dolën këto rekomandime

Rekomandim 1 : Në fshatin Trebinjë të ndërtohen dy puseta për te furnizuar me ujë të pijshëm banorët:

Në fshatin Trebinjë është bërë rehabilitimi nga Ujssjellsi dhe është mundësuar furnizimi i me ujë të pijshëm i banorëve.

Rekomandim 2 : *Problem me ujrat e zeza të cilat derdhen tek lumi i Qytetit:*

Është projekti në zbatim për ujrat e zeza të qytetit

Rekomandim 3 : Rruga që kemi për të kaluar është e ngushtë dhe ka vështirësi në kalimin e mjeteve të mëdha si osh zjarefikse. Sygjerim të merret nga 1 m nga tokat e banorëve dhe të zgjerohet rruga në 5 m.

Nqs arrihet të merren firmat e banorëve atëherë bashkia është dakort.

Rekomandim 4 : Tek Lagjia 4 të ndërtohet një kënd lojrash për fëmijët

Tek lagjia 4 është një kënd lojrash , tek shkolla kështu që Bashkia do rregullojë që ky kënd të jetë i hapur dhe pas orarit të shkollës.

Rekomandim 5: Rruga e Nices;

Rruga e Nicës nuk është në projektin e vitit 2022. Bashkia e ka të pamundur për shkak të mungesës së fondeve.

Rekomandim 6: Në zonën e Trebinjës rrugët e reja që po bëhen janë të bllokuara me makineri, rruga e vjetër është ahumë e amortizuar dhe nuk ka mundësi për kalimin e banorëve.

Po Rruga e Trebinjës është në projektim për vitin 2022.

Rekomandim 7: Ndërtimi i një Këndi lojrash për fëmijë në qendër të fshatit Bucimas



Kjo është një nismë e iniciuar nga Komisioni i Barazisë Gjinore dhe Aleancës së Zgjeruar të Grave Këshilltare dhe do të jetë pjesë e Buxhetit të vitit 2022

Këshilli i Bashkisë, si përfaqësues i komunitetit, falenderon komunitetin për pjesëmarrjen dhe angazhimin në procesin e konsultimit publik dhe ju siguron që opinionet dhe rekomandimet tuaja do të vazhdojnë të merren në konsideratë me qëllim përmirësimin e vendimmarrjes në funksion të përmirësimit të shërbimeve ndaj komunitetit.

Me konsideratë

Jona Bojko

Sekretare e Këshillit

